



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 68912019  
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 23/04/19



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME  
I  
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

LIDHUR ME VIZITËN NË SHTËPINË E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA  
MENDORE NË SHTIME

Për: Z. Skënder Reçica, Ministër  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kopje: Duda Balje, Kryesuese  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinor, Persona të Pagjetur dhe  
Petitione

Z. Qazim Gashi, Udhëheqës  
Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar në Ministrinë e  
Punës dhe Mirëqenies Sociale

Prishtinë, më 23 prill 2019

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit e ka vizituar Shtëpinë e Fëmijëve me nevoja të veçanta në Shtime (në tekstin e mëtejmë “Shtëpia e Fëmijëve në Shtime”)

### Datat e vizitave dhe përbërja e ekipoit monitorues

1. Ky raport u referohet gjetjeve të MKPT-së bazuar në vizitat e realizuara më 9 gusht 2018 dhe më 31 janar 2019 në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime. Gjatë vizitës më 9 gusht 2018, ishte ekipi i MKPT dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejmë “KE”), në cilësi të vëzhguesve. Ndërsa vizita më 31 janar 2019 ishte vizitë përcjellëse, e cila u realizua nga ekipi monitorues i MKPT-së.

### Përshkrimi i përgjithshëm i institucionit

2. Shtëpia e Fëmijëve në Shtime menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe udhëhiqet nga menaxheri i Shtëpisë. Ky institucion është i vetmi në Kosovë i këtij lloji, i cili pat hapur në vitin 2002, me kapacitet deri në dhjetë shtretër. Oftron shërbime 24 orë, si: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, trajtim social. Institucioni nuk ka buxhet të caktuar, të ndarë, të planifikuar dhe të menaxhuar nga udhëheqësi i Shtëpisë, por bazohet në miratimin e kërkuesave nga buxheti i MPMS-së.
3. Shtëpia e Fëmijëve në Shtime është institucion i tipit të hapur, ku rezidentët janë me diagnozën *Pa aftesi në Mësim (Prapambetje mendore)*. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka konstatuar se janë të vendosur 10 persona të moshave të ndryshme (aq sa është kapaciteti i saj): katër nën moshën 18 vjeçare, dy apo i kanë mbushur 18 vjet, dy janë rrëth të njëzetave dhe dy janë rrëth të tridhjetave. Shtatë nga banorët kanë familje. Personeli i Shtëpisë së Fëmijëve në Shtime përbehet prej dhjetë personave, prej tyre një menaxher i Shtëpisë, katër infermierë dhe pesë ndihmës mjekësorë.
4. Për MKPT-në, prezencia e moshës madhore në këtë institucion, i cili në parim është i dedikuar për akomodim dhe strehim të fëmijëve, nuk është e përshtatshme.

### Legjislacioni relevant

5. Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili kishte hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrrregullime mendore. Neni 18 i këtij Ligji parashev nxjerrjen e aktit nënligjor për trajtimin e rezidentëve, të cilët gjenden në institucionet e kujdesit social<sup>1</sup>. Deri më tani nuk është nxjerrë asnjë akt nënligjor.
6. Shtëpia e Fëmijëve në Shtime nuk ka rregullore të veçantë për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta. Sipas udhëheqësit të Divisionit për Aftesi të Kufizuar i MPMS-së,

<sup>1</sup> Neni 18, paragrafi 1, i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.” Paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.”

Shtëpia e Fëmijëve në Shtime vazhdon të rregullohet me dy Udhëzime Administrative: *UA (MPMS) Nr.11/2014 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendorë në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet; si dhe UA me Nr.13/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet- shtëpi për persona me aftësi të kufizuara mendore -ngecje në zhvillimin mendor.*

7. Në bazë të *UA (MPMS) Nr.11/2014*, parashihet trajtimi i personave, të cilëve u është marrë zotësia e veprimit nga gjykata themelore. MKPT-ja i ka analizuar të gjitha rastet në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime dhe ka gjetur se gjashtë prej tyre janë të mos hës madhore, tre prej tyre u është hequr zotësia e veprimit dhe dy të tjerë ishin në procedurë.

### Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

8. Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i Shtëpisë së Fëmijëve në shtime i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat dhe iu mundësuan bisedat me rezidentët, të cilët ishin të vetëdijshëm dhe ishin në gjendje të komunikonin me ekipin, si dhe biseda u realizua pa prezencën e stafit.

### Keqtrajtimi

9. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur një klimë pozitive dhe marrëdhënie të mira mes rezidentëve dhe stafit, qasje të afërt, të ngrohtë e miqësore nga ana e stafit ndaj rezidentëve. MKPT-ja nuk ka rastisur në shenja të lëndimeve trupore tek rezidentët. Nga intervistat me rezidentët, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa për ndonjë formë të keqtrajtimit. Sa u përket vetëlëndimeve, MKPT-ja ka vërejtur se një rezident shpesh bën vetëlëndime, ndërsa të tjerët shumë rrallë. Nuk ka pasur raste të lëndimeve/dhunës me njëri-tjetrin.
10. Në Rekomandimin Rec (2005) 5 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve që jetojnë në Institucionet Rezidenciale, theksohet se: “*Çdo masë kontrolli dhe discipline që mund të përdoret në institucionet rezidenciale, duke përfshirë ato me qëllim të parandalimit të dëmit të vvetves ose dëmtimit të tjerëve, duhet të bazohet në rregulloret publike dhe standartet e aprovuara.*”<sup>2</sup>

### Kushtet e banimit dhe trajtimi

#### Kushtet e banimit

11. Gjatë vizitës së realizuar më 9 gusht 2018, bashkë me ekspertët e KE-së (në cilësinë e vëzhguesve), MKPT-ja ka vërejtur se kushtet materiale për banorët në përgjithësi, ishin shumë të dobëta. Dhomat e rezidentëve kishin hapësirë të mjaftueshme dhe nuk ishin të mbipopulluara, por ishin të dëmtuara. Përveç kësaj, institucioni përballej me mungesa të veshmbathjeve dhe të mbulesave të përshtatshme. MKPT-ja, gjatë kësaj vizite, ka

<sup>2</sup> Këshilli i Evropës: Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec (2005) 5 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për të Drejtat e Fëmijëve që Jetojnë në Institucionet Rezidenciale, 16 mars 2005, Rec (2005) 5, në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/43f5c53d4.html>.

konstatuar se nevojitet riparimi urgjent brenda dhe jashtë Shtëpisë. MKPT-ja u njoftua nga menaxheri i Shtëpisë se i tërë objekti do t'i nënshtrohet një riparimi të rendësishëm, i cili do të përfshijë rreth 90% të Shtëpisë. MKPT-ja, menjëherë pas vizitës së realizuar në gusht të vitit 2018, ka takuar përfaqësues të MPMS-së, ku ka shprehur shqetësimet lidhur me gjetjet.

12. Gjatë vizitës përcjellëse më 31 janar 2019, MKPT-ja konstataoi se objekti në fjalë është riparuar në masë të madhe, është vërejtur se të gjitha hapësirat jashtë Shtëpisë ishin pastruar, janë ndërruar dritaret, është izoluar objekti nga jashtë, janë ndërruar dyert, pllakat, janë rregulluar radiatorët, banjat, është krijuar hapësirë e veçantë për shërbime shëndetësore e terapi dhe se gjendja sa u përket kushteve të akomodimit në përgjithësi ka ndryshuar dukshëm në drejtim pozitiv. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se kuzhina ka nevojë për riparime për ta bërë atë adekuate dhe të sigurt për përdorim.
13. Sipas parimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, të gjithë fëmijët të cilët janë vendosur jashtë familjeve të tyre dhe veçanërisht ata të vendosur në institucione, duhet të rriten me dinjitet, në kushte sa më të mira të mundshme, pa u marginalizuar as gjatë fëmijërisë së tyre apo në moshë madhore.
14. Krijimi i një mjedisi terapeutik pozitiv, përfshinë vënien në dispozicion të hapësirës jetike të mjaftueshme për pacientë si: ndriçim, ngrohje, ajrim të përshtatshëm dhe pastërti në nivel të kënaqshëm. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht ishin dy shtretër në një dhomë, kishte ndriçim natyral, dhomat ishin të ngrohta dhe të pastra, si dhe ishin në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.10, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendorë.<sup>3</sup>
15. Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës<sup>4</sup>, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomatëve të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për t'u dhënë atyre stimulim pamor; gjithashtu, ofrimi i komodinave pranë krevateve dhe gardërobave është shumë e dëshirueshme.
16. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në dhomat e rezidentëve kishte komodina për vendosjen e rrobave dhe të gjërave personale, mirëpo, rezidentët nuk kishin veshmbathje personale të mjaftueshme; gjithashtu, nuk kishte as dekorime për stimulim pamor. Sipas menaxherit të Shtëpisë, sigurimi i veshmbathjeve është më tepër i varur nga donacionet, duke shtuar se shpesh ballafaqohen me vështirësi për sigurimin e tyre.

## Aktivitetet psiko-sociale

17. Rezidentët zakonisht dëgjojnë muzikë, dalin jashtë në natyrë dhe bëjnë disa dalje në qytet, ndonëse të rralla. Tetë nga banorët vijojnë mësimin në shkollë speciale. MKPT-ja konstaton se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është e varfër dhe nuk ka plan të individualizuar të trajtimit sipas nevojave dhe aftësive të rezidentëve.

<sup>3</sup> Neni 6, paragrafi 1.10, i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendorë, përcakton: “Të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë.”

<sup>4</sup> Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, publikuar në mars 2017, në:  
<https://rm.coe.int/16806cd43e>.

18. Gjithashtu, MKPT-ja konstaton se nivelet e personelit të Shtëpisë ishin të pamjaftueshme për të siguruar kujdesin e kërkuar shumë disiplinor. MKPT-ja e vlerëson si shumë të rëndësishme ofrimin e trajnimeve profesionale për stafin, brenda dhe jashtë institucionit, si dhe shpërblimin adekuat, bazuar në specifikat e punës.

### Shërbimet shëndetësore

19. Shërbimi shëndetësor dhe psikiatrik është i përbashkët me Institutin Special në Shtime. Psikiatri vjen një herë në javë, rastet ndonjëherë dërgohen edhe në ambulancën e Institutit Special në Shtime. Në rast nevoje, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, nga Spitali Rajonal në Ferizaj dhe nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.
20. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se Shtëpia e Fëmijëve në Shtime tani ka një dhomë mjekësore për t'i kryer shërbimet mjekësore, ku në të njëjtën dhomë mbahen edhe dosjet shëndetësore edhe barnat. Kishin një aparat për matje të TA, por nuk kanë aparat për oksigen. Dhoma e fizioterapisë nuk ekziston, tani ajo hapësirë është shndërruar në zyre për menaxherin e Shtëpisë, si dhe për shërbime administrative. MKPT-ja vlerëson se duhet të krijohet një hapësirë e veçantë për fizioterapi dhe ta angazhojnë edhe fizioterapeutin.
21. Furnizimi me barna bëhet nga MPMS-ja dhe është i rregullt. MKPT-ja ka vërejtur se, tek rezidentët që përdornin Clozapinën, nuk ka dëshmi se është bërë matja e qelizave të bardha të gjakut, sipas rekomandimeve të bazuara në evidenca. MKPT-ja thekson se është përgjegjësi e institucionit dhënia e medikamenteve të caktuara sipas evidencave të njobura, por edhe aplikimi i monitorimit të efekteve të mundshme anësore të tyre, sipas praktikave të pranuara klinike (analizat përcjellëse tek aplikimi i Clozapinës).
22. Shtëpia e Fëmijëve në Shtime nuk kishte regjistra për evidentimin e lëndimeve trupore, të vetëlëndimeve, të vdekjeve, as regjistrin e lëndimeve të punëtorëve të shkaktuara nga rezidentët apo regjistrin e incidenteve. Sipas njoftimit të stafit, në tri vitet e fundi nuk ka pasur vdekje ose sëmundje serioze. MKPT-ja inkurajon stafin që t'i krijojnë këta regjistra dhe, ngjarjet përkatëse apo incidentet, të përshkruhen hollësisht.

### Mjetet e kufizimit

23. Sa u përket mjeteve të kufizimit, në Shtëpinë e Fëmijëve në shtime nuk ka dhoma të izolimit dhe, sipas stafit, nuk përdoren forma të kufizimit fizik.
24. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës<sup>5</sup>, kufizimi i pacientëve të shqetësuar ose të dhunshëm duhet të jetë, sa më shumë që të jetë e mundur, jo fizike (p.sh. instruksion gojor) dhe, aty ku është i nevojshëm kufizimi fizik, ai në parim duhet të kufizohet në kontroll me duar. Gjatë vizitës së MKPT-së, u intervistua edhe stafi lidhur me çështjen e mjeteve kufizuese në raste të krizave, ku sipas tyre, nuk përdoret asnjë mjet kufizimi, përvèç mbajtjes me dorë në rastet kur ndonjëri nga rezidentët bëhet agresiv. Në ato raste, kujdestarët e natës kërkojnë ndihmën nga psikiatri, apo e thërrasin

<sup>5</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në mars 2017, shih në: <https://rm.coe.int/16806cd43e>.

emergjencën. MKPT-ja, gjatë vizitës, nuk ka gjetur raste të përdorimit të instrumenteve të kufizimit fizik apo veçimit.

### Kontakti me botën e jashtme

25. Disa nga të drejtat e fëmijëve të cilët jetojnë në institucionet rezidenciale, është edhe e drejta për të mbajtur kontakte të rregullta me familjen e fëmijës dhe me njerëz të tjerë të rendësishëm për ta; një kontakt i tillë mund të kufizohet ose të përjashtohet vetëm kur është e nevojshme për interesin më të mirë të fëmijës; e drejta për kontakt me vëllezër të dhe motrat, sa herë që është e mundur, të qëndrojnë së bashku ose të mbajnë kontakte të rregullta.<sup>6</sup>
26. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës thekson se mbajtja e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore jo vetëm për parandalimin e keqtrajtimit, por edhe nga këndvështrimi terapeutik<sup>7</sup>. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se, kohëve të fundit, familjarët e disa rezidentëve kanë interesim për fëmijët e tyre, i vizitojnë edhe shpesh i kontaktojnë përmes telefonit. MKPT-ja përshëndet angazhimin e stafit lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve për të mbajtur kontakte me familjen.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, **Avokati i Popullit i rekomandon**

### Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- T'i furnizojë rezidentët me veshmbathje të përshtatshme për të gjitha stinët e vitit.
- Të krijojë hapësirë të veçantë për fizioterapi.
- Të ofrojë shërbime të veçanta siç janë terapia okupacionale ose mbështetëse.
- Ta furnizojë Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime me materiale pune për zhvillim të aktiviteteve, si dhe të shtohen aktivitetet psiko-sociale.
- Ta riparojë kuzhinën sipas nevojës.
- Të krijojë plane individuale të trajtimit për rezidentët.
- Rezidentëve të cilët përdorin Clozapine t'u bëhen analizat e gjakut në baza të rregullta.

<sup>6</sup> Këshilli i Evropës: Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec (2005) 5 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për të Drejtat e Fëmijëve që Jetojnë në Institucionet Rezidenciale, 16 mars 2005, Rec (2005) 5, në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/43f5c53d4.html>.

<sup>7</sup> Po aty, *Garanci gjatë vendosjes*, paragrafi 54

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësisht ju lutemi që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.



Me ndërime,  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit